

Statistikat e Transportit Hekurudhor

Tremujori IV, 2025


Tiranë, më 30 Janar 2026: Gjatësia e rrjetit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 253 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Kufi - Gjorm 93 km, Durrës - Elbasan 76 km, Rogozhinë – Fier 49 km dhe Fier – Vlorë 35 km. Transporti hekurudhor i mallrave është në distancë 0 - 49 km.

Statistikat e Transportit hekurudhor, për tremujorin e katërt 2025, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuara nëpërmjet rrugëve hekurudhore është 98,9 mijë ton, duke shënuar ulje me 26,0 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2024.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në mijë ton-km rezultoi 3.360,2 nga 4.479,5 mijë ton-km që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke u ulur me 25,0 %.

Fig 1: Transporti hekurudhor i mallrave, 000/ton-km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

“Qymyri dhe linjiti; nafta bruto dhe gazi natyror” sipas klasifikimit NST 2007 (Nomeklatura e Statistikave të Transportit), zënë 93,6 % të mallrave të transportuar me hekurudhë, “Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturina të tjera” zënë 6,2 % dhe grupi “Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve” zënë 0,2 %. (tab.1).


Për publikim 30/01/2026

Tab 1: Mallra të transportuara me hekurudhë sipas NST 2007, në 000/ton

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara në hekurudhë	Mallra gjithsej në 000/ton	
		Tr IV-2025	%
Gjithsej		98,9	100,0
1	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	92,6	93,6
2	Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	6,1	6,2
3	Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve	0,2	0,2

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Në tremujorin e katërt 2025, kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet udhëtimi 178 pasagjerë, duke shënuar ulje me 73,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fig 2: Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 000 pasagjerë/km

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit Hekurudhor paraqet të dhëna tremujore mbi transportin hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor.

Gjatësia e shinave: Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

Pasagjerë të transportuar me hekurudhë: Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet tre mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhor, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash